



Forumi për Iniciativa Qytetare



RAPORT VJETOR

2011

Për FIQ-in

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare që punon në sektorin e sigurisë, zhvillimit të filantropisë dhe mbështetjes përmes granteve të projekteve për qytetari aktive dhe mbrojtje mjedisi.

FIQ është krijuar në vitin 2000 në mënyrë që të adresoj nevojat urgjente në Kosovën e pasluftës. Duke punuar drejtpërdrejt me qytetarët, FIQ tashmë tri vite ka ndërtuar dhe zhvilluar edhe programin e Filantropisë dhe Programin e Granteve.

Programi i Filantropisë nisi në vitin 2009, një traditë kjo e re në shoqërinë tonë, atë të shprehjes së mirënjohjes publike për bizneset, mediat dhe individët të cilët dëshmuar angazhimin e tyre për rritjen e cilësisë së jetesës në Kosovë. FIQ çdo vit, ndanë Çmimin FIDES për filantropi në Kosovë, i cili tashmë është bërë tradicional.

Ndërkaq, përmes Programit të Granteve, FIQ përkrahë iniciativat dhe projektet në mbrojtjen e mjedisit dhe qytetarisë aktive, projektet e organizatave mjedisore, komunitetit dhe grupeve qytetare për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe rritjen e mobilizimit të resurseve lokale.

FIQ ndërmerr nisma dhe është pjesë e nismave dhe konferencave rajonale dhe ndërkombëtare lidhur me zhvillimin e filantropisë, analizimin e politikave dhe promovimin e sigurisë dhe bashkëpunimit rajonal.

Letër nga Drejtori Ekzekutiv



Të nderuar miq dhe kolegë,

Edhe në vitin 2011 punën e FIQ-it e ka karakterizuar puna e drejtpërdrejt me qytetarë, avokimi për tema të ndjeshme të sundimit të ligjit, ndarja e granteve për projekte të qytetarisë aktive dhe mbrojtje të mjedisit, organizimi i dhjetëra tryezave dhe konferencave, dhe partneriteti me organizata joqeveritare në projekte të ndryshme.

Vazhduam për të tretin vit traditën e ndarjes së Çmimit Fides për Filantropi në Kosovë, duke forcuar mirënjohjen dhe falënderimin për ata që kanë dedikuar ndihmën dhe përkrahjen për të mirën e përbashkët të këtij vendi dhe duke kërkuar nga njerëzit vullnetmirë që të punojnë në ruajtjen e dinjitetit qytetar dhe në shprehjen e solidaritetit dhe këmbëngulësisë për zhvillim të qëndrueshëm.

Ndër aktivitetet tona dinamike ishte puna e madhe me grupin e Konzorciumit të OJQ-ve për Energji. Ishte një vit përplot aktivitete, hulumtime, konferenca, reagime, duke kërkuar transparencë dhe politika të drejta e të dobishme për vendin në projektet e mëdha energetike të Kosovës.

Ishim aktiv në organizimin e konferencave rajonale, duke u bërë shtytës të nismave për rritjen e bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë dhe punës policore.

Në tetor, në FIQ pati edhe ndryshime në udhëheqje. Pas pesë vitesh të udhëheqjes me organizatën, Ferdinand Nikolla la këtë detyrë për të vazhduar karrierën e tij në një organizatë tjetër, ndërsa Mexhide Spahija mori detyrën e drejtorit ekzekutiv. Ky tranzicion e ka bërë ndër vite FIQ-in një organizatë që ka respektuar dhe promovuar ndryshimet, duke mos e bazuar udhëheqjen në një individ.

Ne vazhduam të ofrojmë përkrahjen tonë për institucionet e vendit në hartimin, por dhe mbikqyrjen e zbatimit të dokumenteve strategjike në fushën e sigurisë.

Dëshirojmë t'i falënderojmë të gjitha organizatat dhe partnerët me të cilët vazhduam traditën e mirë të organizimit dhe realizimit të projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta, duke qenë kështu pjesë e ndërtimit të asaj që i shërben përgjegjësisë institucionale dhe aktivizmit qytetar.

Falenderim të veçantë donatorëve tanë që vazhdojnë të mbështesin FIQ-in që të vë në jetë misionin e vet!

Mexhide Spahija

SUNDIMI I LIGJIT

Programi për Sundim të Ligjit përqëndrohet në fushën e sigurisë dhe drejtësisë dhe ka për qëllim zhvillimin dhe forcimin e institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në shërbim të qytetarëve. FIQ mëton të arrijë këtë përmes studimeve dhe analizave lidhur me zbatimin e politikave të sigurisë dhe drejtësisë, nxitjen e qytetarëve për të formësuar këto politika, inkurajimin e bashkësisë për përmirësimin e infrastrukturës ligjore në nivel lokal, si dhe ndikimin në hartimin e këtyre politikave. Për më shumë, FIQ avokon tek institucionet për qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë.

“Forcimi i mbikëqyrjes civile në sundimin e ligjit”

FIQ në bashkëpunim me shtatë organizata tjera jo-qeveritare nga komunat e ndryshme të Kosovës realizon projektin “Rritja e mbikëqyrjes publike në sundimin e ligjit në Kosovë”, financuar nga National Endowment for Democracy (NED). Qëllimi i këtij projekti është të ndikoj në funksionalizimin e mekanizmave institucional të llogaridhënies dhe të përfshij qytetarët në vlerësimin e funksionimit të institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë. Në fushën e sigurisë, projekti ka trajtuar temat nga fusha e krimit të organizuar (trafikimi me njerëz, krimet ekonomike dhe financiare, dhe luftimi i lëndëve narkotike), ndërsa nga fusha e drejtësisë është përqëndruar në ofrimin e qasjes në drejtësi për qytetarët dhe zhvillimin e institucioneve të drejtësisë. Komponenta e drejtësisë është realizuar në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Drejtësi (KLI). Puna në këtë projekt përfshinë hartimin e studimeve dhe analizave, organizim të debateve publike, dhe avokim të vazhdueshëm tek institucionet.

Në tryezën me titull “Procesi i riemërimit, pavarësia dhe ndikimet”, të organizuar në kuadër të këtij projekti, u publikua edhe raporti me po këtë emër, ku të pranishmit diskutuan për problemet që e kanë përshkuar procesin e

emërimit dhe ri-emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Aty u tha se këto probleme konsistojnë në: keqadministrimin dhe mospërshtatjen e metodës së testimit të kandidatëve, marrë parasysh se një numër i konsiderueshëm i gjykatësve dhe prokurorëve kishin rënë nga testi i etikës. Përveç kësaj, procesin e kishte përshkuar edhe një problem tjetër, që është mungesa e një mekanizmi mbikëqyrës për të kontrolluar punën dhe cilësinë e punës së gjykatësve dhe prokurorëve, çka ka rezultuar me mosdhënie llogarie për papërgjegjësi. Këto dhe probleme tjera të nxjerra nga raporti dhe të diskutuara në tryezë, u ngritën si çështje që duhen trajtuar nga institucionet përgjegjëse, në mënyrë që në të ardhmen të evitohen problemet e kësaj natyre.



Poashtu në kuadër të këtij projekti, FIQ në bashkëpunim me organizatat partnere, gjatë vitit 2011, ka realizuar edhe disa hulumtime tjera, raporte dhe publikime, ndër të cilat janë edhe “Zbatimi i politikave kundër narkotikëve ilegal” dhe “Luftimi i krimeve ekonomike dhe korrupsionit”.

“Vend i Sigurt”

Është ky program i përbashkët i FIQ dhe Saferworld, i cili përkrahë zhvillimin efektiv të sektorit të sigurisë në Kosovë, të përgjegjshëm dhe të ndjeshëm ndaj konfliktit. Programi “Vend i Sigurt” shtjellon kryesisht këto fusha:

Zhvillimin e kapacitetit të aktorëve qeveritar dhe joqeveritar të angazhuar në zhvillimin e sektorit të sigurisë;

Kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (AVL);
Zhvillimin e qasjeve të duhura ndaj sigurisë në komunitet;

Promovimin e ndjeshmërisë së konfliktit brenda sektorit të sigurisë.



Në kuadër të këtij projekti janë realizuar aktivitete të ndryshme, ndër të cilat fushatat për sigurinë në shkolla, për sigurinë në trafik, fushata kundër gjuajtjes me armë nëpër ahengje me moton “S’ka gëzim as mahi me allti – MOS gjuaj”, e cila u karakterizua me aktivitete të ndryshme të organizuara në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe organizata partnere nëpër shtatë komuna të Kosovës.

Janë mbajtur dy konferenca rajonale, njëra në Podgoricë për sigurinë në bashkësi dhe tjetra në Prishtinë, me temën “Reformat në Polici në Ballkanin Perëndimor”.



Gjithashtu, gjatë vitit 2011, FIQ bashkë me Saferworld, kanë organizuar fushata kundër dhunës nëpër shkolla, si në Prizren, Ferizaj dhe Klinë, në bashkëpunim me Këshillat e Nxënësve nëpër këto qytete, ku janë mbajtur aktivitete të ndryshme si ekspozita, shpërndarje e fletushkave dhe gjithashtu është realizuar dhe shfaqur një film i shkurtër nga nxënësit e komunës së Ferizajt.



FORUMI për SIGURI

Forumi për Siguri edhe në vitin 2011 ka trajtuar tema të ndryshme të sigurisë nacionale. Themelimi i FS është mundësuar nga Saferworld si pjesë e programit “Vendi i Sigurt”, financuar nga qeveria gjermane dhe britanike.

Nga janari 2011, FS ka siguruar mbështetje edhe nga Balkan Trust for Democracy (BTD), që përveç mbështetjes për aktivitetet e forumit, ka mbështetur edhe dizajnimin e ueb faqes së forumit.

Forumi për Siguri ka për qëllim të shërbej si platformë e diskutimit në mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve për çështjet e sigurisë në Kosovë. Me këtë synohet të nxitet komunikimi dhe studimi i politikave në fushën e sigurisë duke ofruar rekomandime konkrete për përmirësimin e saj.

Forumi për Siguri synon poashtu që të ofroj mundësi për shkëmbim të përvojave në çështjet e sigurisë edhe në mes të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe Evropës.

Në kuadër të Forumit për Siguri janë mbajtur tri konferenca, në të cilat janë publikuar këto raporte: Zbatimi “politik” i ligjit, Forca e Sigurisë së Kosovës mes sfidave aktuale dhe vizionit për të ardhmen” dhe “Reformat në Policinë e Kosovës”.

Gjithashtu Forumi për Siguri ka mbajtur edhe konferencën rajonale të ndarjes së përvojave, praktikave më të mira dhe mësimëve të nxjerra në çështjen e reformave në polici në Ballkanin Perëndimor, konferencë kjo e cila mbledhi organizata joqeveritare, ekspertë, institucione të sigurisë nga Kosova, Shqipëria, Bosnja, Mali i Zi dhe Maqedonia, ndërkaq kishte për synim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në proceset e reformave në polici në Ballkanin Perëndimor si dhe fuqizimin dhe promovimin e bashkëpunimit rajonal mes organizatave të ndryshme joqeveritare dhe institucioneve shtetërore të sigurisë.



PROGRAMI I GRANTEVE

Gjatë vitit të kaluar, ne përkrahëm disa projekte mjedisore dhe të qytetarisë aktive.

Fondacioni Familja Bogujevci, e udhëhequr nga fëmijët e familjes Bogujevci nga Podujeva që i kishin shpëtuar ekzekutimeve nga forcat serbe në 1999, kanë mbajtur në Tiranë ekspozitën e tyre "Bogujevci, histori pamore", histori kjo që shërben si homazh për të gjitha viktimat e luftës në Kosovë.

Organizata mjedisore The Ideas Partnership e përbërë nga vullnetarë të devotshëm ka realizuar fushatën e shpërndarjes së çantave të letrës në Mitrovicë, të cilat do t'i përdorin si zëvendësim i qeseve të zakonshme plastike.



Kosovo 2.0 ONLINE



Kosovo 2.0 pulses with voices unfettered and unafraid. Interactive blogs, articles and multimedia bring the untold stories and views of your world and their world. Show yourself at www.kosovotwopointzero.com

Kemi përkrahur revistën dhe webfaqen "Kosova 2.0", e cila ka trajtuar tema të ndjeshme dhe ka shërbyer si mjet për shoqërinë për të shkëmbyer idetë politike, ekonomike, të artit, dhe lidhjen me botën.

Qendra për paqe dhe Tolerancë në Graçanicë aktivizoi dhe mbajti me sukses dhjetëra aktivitete kulturore në Qendrën Alternative Kulturore dhe Rinore, me pjesëmarrje të gjërë të të rinjve në ekspozita, mbrëmje artistike e të tjera.

FIQ, pjesë e Konzorciumit të OJQ-ve për Energji

Gjatë vitit 2011, FIQ ishte njëra nga organizatat nismëtare të Konzorciumit të OJQ-ve për Energji. Së bashku me një grup organizatash joqeveritare, punoi intenzivisht në këtë projekt, i cili synon që përmes aktiviteteve të ndryshme si konferencave, hulumtimeve, reagimeve, të kërkojë transparencë, politika të drejta dhe efikase rreth projekteve të mëdha energjetike në Kosovë.

Ndër aktivitetet e rëndësishme gjatë vitit, vlen të theksohet konferenca e organizuar në tetor me titull “Linjiti i Kosovës dhe efektet e tij në shëndetin publik”, konferencë kjo e cila mbledhi ekspertë ndërkombëtar e vendor të cilët në prezantimet e tyre paraqitën efektet direkte të djegies së qymyrit në shëndetin publik, shkatërrimin e ekosistemit, koston e gjenerimit të energjisë nga qymyri, si dhe efektet tjera anësore që shkakton prodhimi i energjisë nga qymyri në jetën e njerëzve.



Konzorciumi i OJQ-ve për Energji, gjithashtu ka publikuar studimin për sektorin e energjisë në Kosovë. Ky studim kërkimor është një analizë e perspektivave dhe rolit të palëve kryesore me ndikim në sektorin e energjisë në Kosovë, duke u fokusuar në projektet dhe politikat aktuale të energjisë. Studimi analizon strategjinë e Kosovës për energjinë, modelin e tregut të energjisë dhe privatizimin. Konkluzionet dhe shqetësimet e organizatave të përfshira në këtë studim shtrihen prej atyre ekonomike gjatë procesit të privatizimit deri te ato që kanë të bëjnë me ambientin.

FILANTROPIA



FIQ merr pjesë në takimin vjetor për Filantropi

Forumi treditör për Filantropinë në Ballkanin Perëndimor në New York, solli së bashku liderë të filantropisë nga regjioni, për të shtjelluar tema të rëndësishme të bashkëpunimit, qëndrueshmërisë dhe integritit regional të Ballkanit Perëndimor. Diskutimet janë përqëndruar në identifikimin e gjendjes së tanishme të filantropisë në regjion; ndarja e përvojave më të mira; ndihma për të formuluar strategjitë e duhuara për rritje të fondeve në vendet e regjionit, si dhe fushat e bashkëpunimit ndër-kufitar.



Ndarja e Çmimit FIDES 2011

Forumi për Iniciativa Qytetare në bashkëpunim dhe mbështetje nga Fondacioni Rockefeller Brothers Fund, në një ceremoni solemne të mbajtur në Sheshin 21, më 1 dhjetor, ndau për të tretin vit me radhë Çmimin FIDES 2011- çmimin për filantropi në Kosovë. Nazim Haliti, zëvendësrejtör ekzekutiv i FIQ, tha në këtë ceremoni se FIQ me Çmimin FIDES po vendos sistem në njohjen dhe falënderimin e atyre që kanë dedikuar ndihmën dhe përkrahjen për të mirën e përbashkët

Haki Abazi nga Rockefeller Brothers Fund, theksoi se “kjo ngjarje ndihmon në ndërtimin dhe fuqizimin e sistemit të vlerave, që është e vetmja formë për të siguruar se shoqëria kosovare do të jetë në gjendje të tejkalojë trajektoren e vështirësive dhe të krijoj institucione transparente, të cilat do ta çojnë Kosovën drejt familjes europiane.”

Çmimin FIDES 2011 për kontributin në nivel kombëtar e fituan këto kompani: Raiffeisen Bank në Kosovë, për kontributin në arsim, në nxitjen e konkurrencës dhe vlerësimin e cilësisë në arsim; ProCredit Bank për mbështetje në përkrahjen e kategorive të marginalizuara në shoqëri, dhe IPKO



Telecommunications për kontributin në përhapjen e teknologjisë informative, ndërkaq Çmimi FIDES në nivel lokal iu nda kompanisë Elektrostublla nga komuna e Vitisë për kontributin në mbështetjen e organizimit të komunitetit në përmirësimin e infrastrukturës. Çmimin për kontribut individual nga diaspora “Anton Çetta”, e fituan znj. Melinda Rrahimi nga Danimarka për kontributin në mbështetjen e kategorive sociale dhe shkollave në disa komuna në Kosovë dhe znj. Ylfete Fanaj nga Zvicra për kontributin në integrimin shoqëror të bashkëkombasve tanë dhe të huajve në Zvicër, çmim ky të cilin e ndau znj. Donika Çetta, e bija e humanistit të njohur shqiptar, Anton Çetta.

STAFI

Mexhide Spahija – Drejtoreshë Ekzekutive

Nazim Haliti – Zëvendësdrejtor

Sefë Govori – Menaxher i Administratës dhe Financave

Arieta Rexhepi – Zyrtare për Komunikim dhe Asistente e Projektit

Falenderojmë kolegët: Ferdinand Nikolla, Valdrin Grainca, Nita Luzha,
Amire Gashi dhe Florentina Hajdari, të cilët kanë qenë pjesë e FIQ-it gjatë vitit 2011.

OPINION I PAVARUR I AUDITORËVE

Për menaxhmentin e Forumit për Iniciativa Qytetare

Ne i kemi audituar deklaratat financiare, të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore të Forumit për Iniciativa Qytetare në Prishtinë, Kosovë, për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2011 të shprehura në EURO. Këto deklaratat financiare dhe të dhënat financiare shtesë janë përgjegjësi e menaxhmentit të organizatës. Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion në lidhje me informatat financiare të përmendura më lart bazuar në auditimin tonë.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Me këto standarde kërkohet që ne ta planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë garanci të arsyeshme për atë se a janë formularët e raportimit pa deklarime të gabuara materiale. Auditimi përfshin ekzaminimin, bazuar në test, të dëshmisë për të mbështetur shumat dhe publikimet në formularët e raportimit. Në auditim hyn edhe vlerësimi i parimeve të kontabilitetit që përdoren dhe vlerësimet të përafërta të konsiderueshme nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e llogaritjet dhe raportimin e rregullt të të dhënave në lidhje me deklaratat financiare. Ne besojmë se sipas mendimit tonë, auditimi ynë paraqet bazë të arsyeshme.

Sipas opinionit tonë, informatat financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2010 e prezantojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Forumit për Iniciativa Qytetare, ndërsa rezultatet e operacioneve janë në përputhje me marrëveshjet kontraktuese të nënshkruara me donatorët dhe ligjet përkatëse të Kosovës.

Lulzim Zeka
Auditor i autorizuar

BU & Partners
Prishtinë



BU & Partners
Prishtina

Falenderimi i veçantë u takon donatorëve tanë:

B|T|D *The Balkan Trust for Democracy*
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



**Rockefeller
Brothers Fund**
Philanthropy for an Interdependent World



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world



RAPORT VJETOR

2011



Forumi për Iniciativa Qytetare

Aktash, rr. Rexhep Mala 5/A
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel.+381(0)38 248 677
www.fiq-fci.org
www.forumipersiguri.org